




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.54/2024

Datë: 22 shkurt 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 34 par. 1, pika 1.1 i Ligjit 06/L-054 për Gjykatat, si dhe nenit 12 paragrafi 1, i Rregullores Nr. 02/2019 për Rekrutimin, Emërimin, Trajnimin, Shpërblimin, Disiplinimin dhe Lirimin nga Detyra të Gjyqtarëve Porotë, në takimin 321-të, të mbajtur me datë 22 shkurt 2024, merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet dorëheqja e z. Launor Gerbeshi, nga detyra e gjyqtarit porot në Gjykatën Themelore Prishtinë.
- II. Vendimi hyn në fuqi më 22 shkurt 2024.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 21 shkurt 2024, ka pranuar nga Launor Gerbeshi, deklaratën e dorëheqjes nga pozita e gjyqtarit porot në Gjykatën Themelore Prishtinë, për shkak se i njëjti ka filluar në një detyrë të re si zyrtar ligjor në Gjykatën Themelore Prishtinë.

Në takimin e mbajtur më 22 shkurt 2024, Këshilli pas shqyrtimit të kërkesës së z.Gerbeshi, e në bazë të nenit 12.1 pika b) të Rregullores nr. 02/2019 për Rekrutimin, Emërimin, Trajnimin, Shpërblimin, Disiplinimin dhe Lirimin nga Detyra të Gjyqtarëve, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Z. Launor Gerbeshi;
- Kryetares të Gjykatës Themelore Prishtinë;
- Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit.